



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot. _____

Datë _____ .2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET
E ANKIMIMIT**

Data: 03.03.2026

Drejtuar: INA SHPK , NIPT J61814009W dhe me adresë : *Tirane Tirane Rruga “Abdi Toptani”, godina
Business and Shopping Center Torre Drin, kati 1, Nr pasurie 1-143+1-N21*

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Punë**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedure e Hapur**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-69060-11-17-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Rikonstruksion i kopshtit Mehmet Babamusta, CPV Punime ndërtimi
45210000 - 2 Punime ndërtimi për kopështe femijësh 45214100 - 1, Kohezgjatja 7(shtate) muaj

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **19.11.2025** Data e Publikimit të Njoftimit të

Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike **Nr.73 date 25.11.2025**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm
me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. BOE APIS CONSTRUCTION shpk & R[S|M CONSTRUCTION shpk NIPT L41513008A &
L04803001U**

Vlera 26,371,390.34 (njezet e gjashte milion e treqind e shtatedhjetë e një mijë e treqind e nentëdhjetë
pikë tridhjetë e kater) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. NDERTIMI shpk**NIPT K11325002C**

Vlera 26,504,175 (njetzet e gjashte milion e peseqind e kater mije e njeqind e shtatedhjete e pese) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. T & XH shpk**NIPT L72121504I**

Vlera 28,698,395.37 (njetzet e tete milion e gjashteqind e nentedhjete e tete mije e treqind e nentedhjete e pese pike tridhjete e shtate) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. KEVIN KONSTRUKSION shpk**NIPT K71401004W**

Vlera 28,775,586.24 (njetzet e tete milion e shtateqind e shtatedhjete e pese mije e peseqind e tetedhjete e gjashte pike njetzet e kater) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. L.T.E CONSTRUCTION shpk**NIPT K78006801F**

Vlera 28,903,252.30 (njetzet e tete milion e nenteqind e tre mije e dyqind e pesedhjete e dy pike tre) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. DESARET COMPANY shpk**NIPT K01816001J**

Vlera 29,761,941.63 (njetzet e nente milion e shtateqind e gjashtedhjete e nje mije e nenteqind e dyzet e nje pike gjashtedhjete e tre) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. C O L O M B O shpk**NIPT J82916489E**

Vlera 29,975,172 (njetzet e nente milion e nenteqind e shtatedhjete e pese mije e njeqind e shtatedhjete e dy) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. GRIALD shpk**NIPT J68117216C**

Vlera 30,464,059 (tridhjete milion e katerqind e gjashtedhjete e kater mije e pesedhjete e nente) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

9. INA shpk

NIPT J61814009W

Vlera 30,982,956 (tridhjetë milion e nentëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nentëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

10.LIQENI VII shpk

NIPT K01730502W

Vlera 32,693,873.7 (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre pike shatate) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

11.ED KONSTRUKSION shpk

NIPT K61625001I

Vlera 35,989,300 (tridhjetë e pesë milion e nentëqind e tetëdhjetë e nente mijë e treqind) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

12.ERGI shpk

NIPT K02727229P

Vlera 37,150,879.2 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nente pike dy) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

13.DAJTI PARK 2007 shpk

NIPT K11507003S

Vlera 38,079,696 (tridhjetë e tetë milion e shtatëdhjetë e nente mijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

14.Z D R A V A shpk

NIPT J84003411K

Vlera 39,566,587 (tridhjetë e nente milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE APIS CONSTRUCTION shpk & R|S|M CONSTRUCTION shpk NIPT L41513008A & L04803001U

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “**BOE APIS CONSTRUCTION shpk & R|S|M CONSTRUCTION shpk**” u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Janë paraqitur Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë Apis Construction shpk dhe RSM Construction shpk, si dhe të operatorit ekonomik 2T shpk si operator ekonomik mbështetës.

Referuar këtyre formularëve dhe deklaratës së angazhimit të operatorit ekonomik mbështetës 2T shpk, konstatohet se:

- i. Operatori ekonomik RSM Construction shpk nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit se do të mbështetet në kapacitet e operatorit ekonomik 2T shpk
- ii. Gjithashtu në deklaratën e angazhimit të operatorit ekonomik mbështetës 2T shpk, thuhet se ky I fundit do të mbështete e kapacitete vetëm operatorin ekonomik Apis Construction shpk

Referuar VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 90 pika 2 thuhet se “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës”. Bashkimi I operatorëve ekonomikë oferton në procedurat e prokurimit si një operator ekonomik I vetëm, për këtë arsye duhet, që në këtë rast, të dy të deklarojnë mbështetjen në kapacitetet e operatorëve të tjerë ekonomikë.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik **Apis Construction shpk** ka paraqitur katër kontrata, nga shqyrtimi I secilës prej tyre rezulton se:

1. **Meremetim hidroizolim shkolla 9-vjecare** (Bashkia Selenice) operatori merr persiper realizimin e 50% te punimeve ose 4,845,024 leke pa tvsh Kjo kontrate nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.1, për disa arsye:
 - nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit.
2. **Ndertimi pusi I ri nr.4 Vrion, godina dhe lidhja e tubacionit.** (Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande). operatori merr persiper realizimin e 29.4% te punimeve ose 8,128,544.63 leke pa tvsh. Kjo kontrate nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.1, për disa arsye:
 - i. nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit.
 - ii. nuk jane percaktuar ne kontraten e bashkepunimit elementet konkrete qe merr persiper te realizoje secili anetar I bashkimit. Megjithatë, nëse do te marrim per baze zërat ndërtimore për godina të preventivit, vlera e 29.4 % është ±1,000,000 leke pa tvsh.
3. **Ndertim pedonale, piste vrapimi dhe korsi bicikletash ne liqenin e Farkes.** Kjo kontrate nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.1, për disa arsye:
 - i. nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit

ii. Operatori ekonomik është nënkontraktor I punimeve të ndërtimi. Është paraqitur kontrata e nënkontraktimit, por ska kontratë bazë të lidhur me Bashkinë Tirane. Nënkontratat janë të vlefshme vetëm në rastin kur lejohen nga Autoriteti Kontraktor dhe duhet që Nënkontraktori të deklarohej në kontratën bazë.

iii. Nuk është paraqitur akt kolaudimi sic parashikohet në Shtypcën 9 “Formular Vlerësimi”

4. **Spektori I pastrimit, punime te vendgrumbullimi I mbetjeve, demtimeve nga zjarri** (Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore. Operatori merr persiper realizimin e 50% te punimeve ose 2,533,460 leke pa tvsh. Kjo kontrate nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.1, për disa arsye:

i. nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit

ii. Zërat e punimeve në kontratën e bashkepunimit dhe situacionit 1 (I vetmi) nuk përputhen.

iii. Nuk është paraqitur akt kolaudimi sic parashikohet në Shtypcën 9 “Formular Vlerësimi”

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4.5 të kriterëve te veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponibilitetin e stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për për 3 (tre) shoferë.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate” ofertuesi BOE Apis Construction shpk dhe RSM Construction shpk kanë deklaruar ndër të tjera se kanë vetëm dy nga tre shoferë të kërkuar, konkretisht punonjësit Gj. Q. dhe T.GJ. shoferë të punësuar në këto shoqëri.

3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve te veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku te perfshihet kesti per periudhen perkatese te maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Operatori ekonomik RSM Construction shpk aktualisht ka kontratë për realizimin e punëve publike me Bashkinë Kavajë, për të cilën nuk ka regjistruar në QKB adresën e ushtrimit të aktivitetit në vende të tjera dhe nuk ka shlyer detyrimet vendore pranë Bashkisë Kavajë.

2. NDERTIMI shpk

NIPT K11325002C

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **NDERTIMI shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotëson të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve te veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik **Ndertimi shpk** ka paraqitur kontratën me objekt “Rikualifikim I rruges Silvio Berlusconi dhe ndertim ruget Sander Prosi, Ernest Koliqi, Qemal Stafa (Bashkia Kamez)” me vlerë 58,037,072 leke pa tvsh. Kjo kontrate nuk ka natyre te ngjashme me objektin e prokurimit.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kasti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Është paraqitur në SPE dokumenti kontrate me objekt “Rikualifikim i rruges Silvio Berlusconi dhe ndërtim rrugës Sander Prosi, Ernest Koliqi, Qemal Stafa” lidhur me Bashkia Kamez, realizuar gjatë afatit kohor 27.12.2024 deri 12.06.2025. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokument për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamez.

3. T & XH shpk

NIPT L72121504I

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepet dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **T & XH shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotëson të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si më poshtë:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kasti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Referuar të dhënave të Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të operatorit ekonomik T&XH shpk, pika 13 “Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit” citohej ndër të tjera adresat:

- Durrës Durrës Zona Kadastrale: Z.K. 8511; Nr. Pasurie 17/931 Bashkia Durrës
- Durrës Durrës DURRES Nr. pasurie 4/543/ND-N6, Zona kadastrale 8514, Lagjia Nr.3, Rruga “Skenderbej”, Godina përballë tatim-taksave, Durrës. 2001
- Durrës Durrës DURRES Durrës, Rruga "Adem Jashari", Zona Kadastrale 2574, Nr pasurie 159/154 dhe 159/162, njesia Administrative Xhafzotaj 2019
- Korce Korçë Zona Kadastrale 1538, Fshati Qatrom, Korçë
- Berat Berat BERAT Zona Kadastrale: Z.K. 8504; Nr. pasurie 30/34 dhe 30/33 Bashkia Berat

Ndër këto, është paraqitur vërtetime vetëm nga Bashkia Durrës, të cilat vërtetojnë se subjekti ka shlyer taksat vendore deri në Qershor 2025 dhe në një rast deri në datën e mbylljes së njëres prej adresave që ka patur në Durrës.

Për dy adresat e tjera, të Korcës dhe të Beratit, nuk është paraqitur asnjë dokument që vërteton se operatori ekonomik T&XH shpk nuk ka detyrime të pa shlyera.

Gjithashtu, mbështetur në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nën 90 pika 2 thuhet se “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet t’i provojë autoritetit/entitetit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.”, operatori ekonomik mbështetës “E&E” Ndërtim shpk nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton se nuk ka detyrime të pa shlyera nga taksat vendore në vendet e ushtrimit të aktivitetit.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin e personelit kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese, konkretisht

- i. për 1(një) Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” operatori ekonomik **T&XH shpk** ka deklaruar ndër të tjera drejtuesin teknik E.N. (me numër rëndor 8) i deklaruar si inxhinier

Gjeolog. Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se, A. N. është I diplomuar si inxhinier Gjeodet.

- ii. për 1(një) Inxhinier Mjedisi dhe 1(një) Inxhinier Hidroteknik. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate” operatori ekonomik **T&XH shpk** ka deklaruar ndër të tjera drejtuesit teknikë S.T. (me numër rëndor 4) deklaruar si inxhinierë mjedisi dhe A. K. deklaruar si inxhinierë hidroteknike. Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik, konkretisht CV e secilit prej tyre, rezulton se, këta drejtues teknikë janë të punësuar edhe në shoqëri të tjera.

3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin e 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate” operatori ekonomik **T&XH shpk** ka deklaruar ndër të tjera punonjës H.H. si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë. Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se, nuk është paraqitur kontratë pune ndërmjet operatori ekonomik **T&XH shpk** dhe punonjës H.H. Janë paraqitur vetëm faqet e para të dy kontrave, nga të cilat njëra me afat vlefshmërie të përfunduar.

4. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 1/ç të kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pasi operatori ekonomik mbështetës I.D.K-KONSTRUKSION shpk nuk ka paraqitur vërtetim se) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të percaktuar në nenin 76/1 të LPP-së; konkretisht për administratorin dhe ortakun e vetëm të shoqërisë.

Kjo bien ndesh me kërkesat e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 90 pika 2 thuhet se “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.”

Duhet të theksojmë se ka një paqartësi të dhënash të deklarua në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në SPE, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të sjellë manualisht dhe të dhënave të Ekstraktit të Regjistrat Tregtar të operatorit ekonomik I.D.K-KONSTRUKSION shpk në lidhje me personin (personat) që veprojnë si anëtar të organit administrativ dhe aksioneri ose ortak.

4. KEVIN KONSTRUKSION shpk

NIPT K71401004W

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **KEVIN KONSTRUKSION shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotëson të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin

2025, ku te perfsihet kesti per periudhen perkatese te maturuar, sipas percaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Operatori ekonomik Kevin Construction shpk aktualisht ka kontratë për realizimin e punëve publike me Bashkinë Kavajë, për të cilën nuk ka regjistruar në QKB adresën e ushtrimit të aktivitetit në vende të tjera dhe nuk ka shlyer detyrimet vendore pranë Bashkisë Kavajë.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin e personelit kryesor, drejtues teknikë licencën e shoqërisë ofertuese, konkretisht për 1(një) Inxhinier Ndertimi (profil strukturist).

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Kevin Construction shpk dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbështetës ALB TIEFBAU shpk, konstatohet se operatorit ekonomik mbështetës ALB TIEFBAU shpk do të mbështesë me drejtuesin teknik Inxhinier Ndertimi (profil strukturist) A.M..

Në VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Kreu IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë” pika 2 paragrafi I dytë thuhet se “Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi ...”.

Në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “**Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera**” thuhet “Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.”

Nisur nga sa më sipër:

- VKM Nr.42, datë 16.1.2008 ndalon drejtuesin teknik të angazhohet në zbatimin e punimeve të ndërtimit nga shoqëri të tjera.
- Ligji nr 162/2020 “Për Prokurimin public” kushtozon realizimin e kryerjes së punëve nga shubjekti mbështetës, gjë që nuk është marrë përsipër nga Operatori ekonomik ALB TIEFBAU shpk

5. L.T.E CONSTRUCTION shpk

NIPT K78006801F

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **L.T.E CONSTRUCTION shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

Bazuar ne nenin 82 pika 4 e Vkm 285 date 19,05,2021 oferta juaj eshte oferte anomalisht e ulet.

6. DESARET COMPANY shpk

NIPT K01816001J

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **DESARET COMPANY shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Referuar të dhënave të Ekstraktit Historik të Regjistrit Tregtar, citohet se më datë 04.03.2025 është Shtuar Adresa: *Durres; DURRES; Durres; “Riparim/rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Kushtrimi i Lirisë”, me nr. pasurie 7/110, vol. 37, fq. 186, zona kadastrale 8513, me vendndodhje rruga “Enver Velja”, Lagjja nr. 5, Njësia Administrative Nr. 3, Durrës*”. Operatori ekonomik bashkë me dokumentacionin provues të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor ka paraqitur vërtetime të pagesave të taksave vendore, ndër të cilat rezulton të ketë vërtetim për pagesën e taksave vendore në Bashkinë Durrës vetëm për vitin 2024. Shlyerja e taksave vendore për Bashkinë Durrës për vitin 2024 është bërë më datë 01.04.2025 dhe vërtetimi përkatës është marrë më datë 10.04.2025.

Operatori ekonomik Desaret Company shpk ka detyrime të pashlyera në Bashkinë Durrës.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponibilitetin e stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 1 (një) inxhinier ndërtimi.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate” ofertuesi ka deklaruar se disponon personelin kryesor konkretisht Z. Sotiraq Pandazi, me profesion Inxhinier Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik.

Është paraqitur gjithashtu dokumenti 1_SOTIRAQ_PANDAZI_-_INXHINIER_NDERTIMI, nga shqyrtimi I të cilin konstatohet se z. Sotiraq Pandazi në diplomën e tij dhe Licencën Z.1211/3 është inxhinier hidroteknik, I deklaruar si I tillë edhe nga vetë z. Sotiraq Pandazi në CV e paraqitur bashkangjur dokumentacionit përkatës.

3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për plotësimin e kërkesës për pajisje me me leje mjedisore kodë III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

- i. Është paraqitur leje mjedisore III2B jo në përputhje me kërkesën 2.3.7. Subjektit I lejohet vetëm transporti I mbetjeve jo të rrezikshme (letër, karton, plastikë, qelq, mbetje të biodegradueshme apo druri etj), klasifikimi I të cilave nuk përputhet me objektin e prokurimit.

- ii. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “ Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik” ofertuesi ka deklaruar se do të mbështet në kapacitetet e operatorit ekonomik REJ shpk, ndër të tjera për LEJE III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” thuhet “Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.”

Referuar nenit të mësipërm, operatorët ekonomikë me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, më saktë kërkesat e nevojme për realizimin e objektit të prokurimit, mund të mbështeten në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera. Por kjo gjë nuk është e mundur në rastin e lejeve, licencave apo certifikimeve të një subjekti tjetër pasi

është e drejtë ekskluzive e tyre dhe vetëm këta të fundit kanë të drejtën të ushtrojnë veprimtari në bazë të lejeve, licencave apo certifikimeve të lëshuara në favor të tyre.

Është e pamundur që operatori ekonomik Desaret Company shpk të realizojë transportin e mbetjeve ndërtimore me mjetet dhe shoferët e vet, duke përdorur Licencën e kategorisë III.2.B të operatorit ekonomik mbështetës REJ shpk.

7. C O L O M B O shpk

NIPT J82916489E

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **C O L O M B O shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

Per proceduren me REF-69060-11-17-2025 me objekt “Rikonstruksioni i kopshtit Mehmet Babamusta” i eshte derguar kerkese per dorezim dokumentacioni operatorit ekonomik “Colombo” shpk ne sistem me date 18.02.2026 bazuar ne nenin 26 te VKM 285 date 19.05.2021.

Ne kete kerkese eshte kerkuar qe dokumentacioni i operatorit ekonomik i shpallur fitues paraprak te dorezohej origjinal ose i noterizuar prane Bashkise Kavaje me date 23.02.2026. Colombo shpk nuk eshte paraqitur prane autoritetit kontraktor dhe as ka sjelle me poste dokumentacionin e kerkuar.

Nisur nga kjo Komisioni i Vleresimit te Ofertave e quan te pavlefshme oferten tuaj.

8. GRIALD shpk

NIPT J68117216C

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **GRIALD shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik **Griald shpk** ka paraqitur kontratën me objekt “Rehabilitimi nga rreshqitjet massive të shpatit të malit, punime mirembajtje dhe rikonstruksion I turbinës nr.1 1250kv, rikonstruksion I pjesshem ne objektin Cernaleve” me vlerë 37,770,841 leke pa tvsh. Afati I kontratës 01.01.2018 deri 30.11.2022. Kjo kontratë është e papranueshme për disa arsye:

- i. nuk ka natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit.
- ii. Nuk është paraqitur akt kolaudimi sic parashikohet në Shtypcën 9 “Formular Vlerësimi”
- iii. Kjo kontratë nuk është realizuar gjatë 5 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Me shumë se gjysma e punimeve janë realizuar para afatit 5-vjeçar.
- iv. Punimet me natyrë ndërtimë godinash nuk përmbushin kushtin 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe një pjesë e madhe e tyre janë realizuar deri në 2020, referuar situatave dhe faturave përkatëse.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponimin e personelit kryesor, drejtues teknikë licencën e shoqërisë ofertuese, konkretisht për 1(një) Inxhinier Ndërtimi (profil strukturist).

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Griald shpk dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbështetës Bajrami N shpk, konstatohet se operatorit ekonomik mbështetës Bajrami N shpk do të mbështesë me drejtuesin teknik Inxhinier Ndërtimi F.K..

Në VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Kreu IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë” pika 2 paragrafi I dytë thuhet se “Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi ...”.

Në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “**Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera**” thuhet “Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.”

Nisur nga sa më sipër:

- VKM Nr.42, datë 16.1.2008 ndalon drejtuesin teknik të angazhohet në zbatimin e punimeve të ndërtimit nga shoqëri të tjera.
 - Ligji nr 162/2020 “Për Prokurimin public” kushtozon realizimin e kryerjes së punëve nga shubjekti mbështetës, gjë që nuk është marrë përsipër nga Operatori ekonomik Bajrami N shpk
3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponueshmërinë e Licencës së kategorisë III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinin, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Griald shpk dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbështetës ALB TIEFBAU shpk, konstatohet se operatorit ekonomik mbështetës Bajrami N shpk do të mbështesë ndër të tjera me

Në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “**Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera**” thuhet “Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.”

Referuar nenit të mësipërm, operatorët ekonomikë me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, më saktë kërkesat e nevojme për realizimin e objektit të prokurimit, mund të mbështeten në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera. Por kjo gjë nuk është e mundur në rastin e lejeve, licencave apo certifikimeve të një subjekti tjetër pasi është e drejtë ekskluzive e tyre dhe vetëm këta të fundit kanë të drejtën të ushtrojnë veprimtari në bazë të lejeve, licencave apo certifikimeve të lëshuara në favor të tyre.

Është e pamundur që operatori ekonomik Griald shpk të realizojë transportin e mbetjeve ndërtimore me mjetet dhe shoferët e vet, duke përdorur Licencën e kategorisë III.2.B të operatorit ekonomik mbështetës ALB TIEFBAU shpk.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **INA SHPK**, NIPT J61814009W dhe me adresë : *Tirane Tirane Rruga “Abdi Toptani”, godina Business and Shopping Center Torre Drin, kati 1, Nr pasurie 1-143+1-N21* se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 30,982,956 (tridhjetë milion e nentëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nentëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.